



Është aktivist i Lëvizjes Vetëvendosje dhe aktualisht është angazhuar në Prishtinë, si Këshilltar Politik i Kryetarit të këtij subjekti. Në të shkuarën ka qenë aktivist i shoqërisë civile në Tiranë, ku ka qenë një ndër themeluesit e blogut radikal Saktivista¹ dhe Institutit Antonio Gramshi. Më parë ai ka punuar si Makroeditor pranë Gazetës Shekulli, si Drejtues Projektesh në Lëvizjen Mjaft, ndërsa ka patur bashkëpunime të rregullta si publicist me Revistën Klan, Revistën Shenja, Gazetën Shqip, Respublica etj. Ai ka studiuar shkenca politike dhe filozofi, dhe shkruan e përkthen prozë, poezi apo teori (eseistik²).